

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të  
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Kontabiliteti Financiar  
Financial Accounting**

**P1**

**Zgjidhjet**

FLETË PROVIMI  
Exam Paper

Data 14.01.2017

CONTENT / PËRMBAJTJA

<b>Pjesa</b>	<b>Maksimumi i Dhënë</b>	<u>-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK- PIKËT E DHËNA</u>
1. Problemi 1	20	
2. Problemi 2	20	
3. Problemi 3	20	
4. Problemi 4	20	
5. Problemi 5	20	
<b>Total</b>	<b>100</b>	

## **Problemi 1**

Bilanci Vërtetues i Kujtimit Sh.p.k., kompani e përfshirë në industrinë e prodhimit, kishte një llogari pezull me vlerë prej 14,400€ në kredi më 31 dhjetor 2015. Të shqetësuar me këtë fakt, menaxhmenti ka kërkuar nga ju që të hetoni llogaritë, ku si rrjedhojë keni zbuluar çështjet e mëposhtme:

1. Një faturë në lidhje me tarifat e kontabilitetit në vlerë prej 3,200€ duhet të kontabilizohet.
2. Një zbritje në lejimet e llogarive të arkëtueshme në vlerë prej 4,600€, gabimisht i ishte debituar llogarisë së shpenzimeve të borxheve të këqija dhe i ishte debituar gjithashtu llogarisë së lejimeve.
3. Në të hyrat nga shitjet ishte përfshirë ishte shitja e aksioneve me vlerën e tyre nominale në vlerë prej 15,600€. Shuma është paraqitur saktë në llogarinë bankare.
4. Shtimet (blerjet shitesë) në Pronën, Fabrikën dhe Pajisjet me kosto prej 8,000€ dhe të paguara me çek më 01 korrik 2015, janë regjistruar në llogarinë e shpenzimeve të riparimit dhe mirëmbajtjes. Politikë e Kujtimi Sh.p.k. është zhvlerësimi i plotë në vitin e blerjes me normën 15% në vit.
5. Për shkak të një gabimi softuerik, të hyrat nga shitjet në vlerë prej 7,100€ i janë debituar llogarisë të pagueshmeve tregtare dhe gjithashtu llogarisë së arkëtueshme.
6. Shpenzimet e qerasë në vlerë prej 840€ të paguara në para të gatshme janë regjistruar gabimisht në llogarinë e parapagimit.
7. Dividenda e paguar në vlerë prej 2,300€ i është kredituar llogarisë së shpenzimeve financiare dhe parasë së gatshme.
8. Pagat e paguara Z.Kujtimit (pronarit) në vlerë prej 2,200€ i janë kredituar llogarisë së kapitalit të pronarit dhe parasë së gatshme.

### **KËRKOHET:**

- a) Përgatitni hyrjet në ditar për Kujtimit Sh.p.k. për të regjistruar dhe korrigjuar transaksionet relevante, duke u bazuar në informatat e mësipërme për pasqyrat financiare të vitit që përfundon më 31 dhjetor 2015. **(15 pikë)**
- b) Përgatitni llogarinë pezull për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2015. **(5 pikë)**

**[Total: 20 pikë]**

## Zgjidhja e problemit 1

### Korrigjimet e transaksioneve:

1)	Debi Shpenzimet e tarifave	3,200€	
	Kredi Paraja e gatshme	3,200€	
2)	Debi Shpenzimet e borxheve të dyshimta	4,600€	
	Debi Llogaria Pezull	9,200€	
	Kredi Shpenzimet e borxheve të këqija	4,600€	
	Kredi Lejimi (për korrigjimin e gabimit)	4,600€	
	Kredi Lejimi	4,600€	
3)	Debi Të hyrat nga shitja	15,600€	
	Kredi Aksionet e zakonshme	15,600€	
4)	Debi P.F.P. (Pjq)	8,000€	
	Kredi Shpenzimet e riparimit	8,000€	
	Debi Shpenzimet e zhvlerësimit	1,200€	
	Kredi Zhvlerësimi i akumuluar	1,200€	
5)	Debi Llogaria Pezull	14,200€	
	Kredi Llogaria e Pagueshme	7,100€	
	Kredi Të hyrat nga shitjet	7,100€	
6)	Debi Shpenzimet e qirasë	840€	
	Kredi Parapagimi	840€	
7)	Debi Shpenzimet financiare	2,300€	
	Debi Dividenda e pagueshme	2,300€	
	Kredi Llogaria Pezull	4,600€	
8)	Debi Pagat	2,200€	
	Debi Kapitali i pronarit	2,200€	
	Kredia Llogaria Pezull	4,400€	

### Llogaria pezull

Korrigjimi (2)	9,200€	Saldo në fillim	14,400€
Korrigjimi (5)	14,200€	Korrigjimi (7)	4,600€
		Korrigjimi (8)	4,400€
		Saldo në fund	0€

## Problemi 2

**Shënim:** Kjo pyetje është e ndarë në dy pjesë: Pjesa 1 dhe Pjesa 2. Ju duhet të mbani parasysh se ndërmarrjet e paraqitura në të dy pjesët, janë të ndara dhe nuk janë të lidhura me njëra tjetrën.

**Pjesa 1:** Znj. Nora, drejtoreshë menaxhuese e Nora Sh.p.k. ka një numër pyetjesh në lidhje me stoqet dhe ju ka kërkuar juve të e këshilloni duke u bazuar në SNK 2 – Stoqet. Si pjesë e inventarit të saj të përgjithshëm, Nora Sh.p.k. ka tre artikuj të stoqeve, kostot dhe vlera neto e realizueshme (VNR) e të cilëve është si në vijim:

Artikulli	Kosto - €	VNR - €
1	72	80
2	56	48
3	<u>92</u>	<u>96</u>
	220	224

### **KËRKOHET:**

- a) Kalkuloni vlerën në fund të secilit artikull të stoqeve dhe si rrjedhojë edhe vlerën totale të stoqeve në fund të Nora sh.p.k. **(4 pikë)**
- b) Në kontekstin e SNK 2 – *Stoqet*, përgatitni një raport për Znj. Nora, i cili:
  - i) Përshkruan artikujt që e përbëjnë inventarin (stoqe);
  - ii) Shpjegoni se si maten/vlerësohen stoqet;
  - iii) Ofroni tre shembuj të kostove të cilat në mënyrë specifike përjashtohen (nuk përfshihen) në kostot e stoqeve, por njihen si shpenzime në periudhën në të cilën kanë ndodhur;
  - iv) Shkurtimisht diskutoni tre situata në të cilat vlera neto e realizueshme ka gjasa të jetë më e vogël se kosto. **(12 pikë)**

**Pjesa 2:** Stoqet në fund më 31 dhjetor 2015 të Dafina Sh.p.k. janë 347,841€. Kjo shumë përfshinë artikuj në vlerë prej 4,640€ të cilat ishin shkatërruar aksidentalisht më 31 dhjetor 2015, pasi që numërimi kishte përfunduar. Në atë shumë ishin të përfshira gjithashtu artikuj në vlerë prej 2,980€ të dëmtuar në tetor 2015, artikuj të cilët mund të ripërpunohen me një kosto prej 680€ dhe të shiten pastaj me një çmim prej 2,410€.

### **KËRKOHET:**

Kalkuloni vlerën e stoqeve në fund të Dafina sh.p.k..

**(4 pikë)**

**[Total: 20 pikë]**

## Zgjidhja e problemit 2

**Për:** Znj. Nora, Drejtoreshë menaxhuese e Nora sh.p.k.

**Nga:** Tekniku i Kontabilitetit

**Tema:** SNK 2 – Stoqet

**Data:** Janar 2017

- a) Sipas SNK 2 – Stoqet, stoqet vlerësohen sipas Kostos ose Vlerës Neto të Realizueshme cilado që është më e ulëta. Stoqet me vlerë prej 212€ janë stoqet në fund për biznesin tuaj.

Artikulli	Kosto - €	VNR - €	Më e ulëta - €
1	72	80	72
2	56	48	48
3	<u>92</u>	<u>96</u>	<u>92</u>
	220	224	212

- b) i) Artikujt që i përbëjnë stoqet sipas SNK 2 janë:

1. Mallrat
2. Lënda e parë
3. Materialet
4. Puna në progres
5. Produktet e gatshme të prodhuara

ii) Stoqet maten/vlerësohen sipas kosto ose vlerës neto të realizueshme, cilado që është më e ulëta.

iii) Paragrafi 16 i SNK 2 nënvizon shembujt e kostove të cilat janë të përjashtuara nga kosto e stoqeve dhe të cilat njihen si shpenzimet të periudhës në të cilën kanë ndodhur, psh:

1. Shpenzimet e tepërta për materialet e humbura, të punës ose kostove tjera të prodhimit;
2. Shpenzimet e magazinimit, përveç nëse këto shpenzime janë të nevojshme në procesin e prodhimit, kur prodhimi është në faza, si pjesë e një faza të prodhimit para fazës tjetër të mëtutjshme;
3. Shpenzimet administrative të cilat nuk kontribuojnë në sjelljen e stoqeve në vendin dhe gjendjen aktuale; dhe
4. Shpenzimet e shitjes.

iv) Situatat në të cilat vlera neto e realizueshme ka gjasa të jetë më e vogël se kosto e stoqeve është kur:

1. Ka ndodhur një rritje në kosto ose një rënie në çmimin e shitjes;
2. Dëmtimi fizik i stoqeve;
3. Vjetërsimi i produkteve;
4. Vendimi, si pjesë e strategjisë së ndërmarrjes për prodhimin dhe shitjen e produkteve me humbje;
5. Gabimet në prodhim ose blerje.

Për informata shtesë, ju lutem mos hezitoni të më kontaktoni!

Me respekt,

Tekniku i Kontabilitetit

**Pjesa 2: Vlera e stoqeve në fund për Dafina sh.p.k.**

Total Stoqet në fund me kosto (si rrjedhojë e numrimit)	347,841€
Stoqet e shkatërruara aksidentalisht	(4,640€)
Stoqet e dëmtuara – kosto	2,980€
VNR – Çmimi i shitjes minus kostot për t’u realizuar shitja (2,410 – 680)	(1,730€)
Humbja nga rënia në vlerë	<u>(1,250€)</u>
	<b>341,951€</b>

**[Total: 20 pikë]**

### Problemi 3

Mia Sh.p.k. është e përfshirë në prodhimin e supave. Pasqyrat financiare të kësaj ndërmarrje janë paraqitur në vijim:

<b>Pasqyra e Pozitës Financiare e Mia Sh.p.k.më 31 dhjetor 2015</b>		
	<b>2015</b>	<b>2014</b>
<b>PASURITË</b>	<b>'000€</b>	<b>'000€</b>
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>		
Prona, Fabrika dhe Pajisjet	<u>1,942</u>	<u>1,628</u>
<i>Total pasuritë jo-qarkulluese</i>	<b>1,942</b>	<b>1,628</b>
<i>Pasuritë qarkulluese</i>		
Stoqet	196	129
Llogaritë e arkëtueshme	187	199
Keshi dhe ekuivalentët e tij	<u>53</u>	<u>54</u>
<i>Total pasuritë qarkulluese</i>	<b>436</b>	<b>382</b>
<b>TOTAL PASURITË</b>	<b><u>2,378</u></b>	<b><u>2,010</u></b>
<b>EKUITETI</b>		
Aksionet e zakonshme	140	100
Premia	45	45
Fitimet e mbajtura	1,499	1,014
Rezerva e Rivlerësimit	<u>48</u>	<u>26</u>
<i>Total Ekuiteti</i>	<b>1,732</b>	<b>1,185</b>
<b>DETYRIMET</b>		
<i>Detyrimet afatgjata</i>		
Kredia	<u>512</u>	<u>646</u>
<i>Total detyrimet afatgjata</i>	<b>512</b>	<b>646</b>
<i>Detyrimet afatshkurtra</i>		
Llogaritë e pagueshme	115	146
Overdrafti	-	12
Tatimi i pagueshëm	<u>19</u>	<u>21</u>
<i>Total detyrimet afatshkurtra</i>	<b>134</b>	<b>179</b>
<b>TOTAL EKUITETI DHE DETYRIMET</b>	<b><u>2,378</u></b>	<b><u>2,010</u></b>



**Pasqyra e të ardhurave dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse e Mia Sh.p.k.  
për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2015**

	'000€
Të hyrat	3,658
Kosto e shitjes	(2,672)
<hr/>	
Fitimi Bruto	986
Shpenzimet e shpërndarjes	(169)
Shpenzimet administrative	(157)
Shpenzimet e interesit	(34)
<hr/>	
Fitimi para tatimit	626
Shpenzimet e tatimit	(95)
<hr/>	
Fitimi neto	531

**Shënimet shtesë:**

- a) Prona, Fabrika dhe Pajisja me vlerë neto në libra prej 200,000€, u shit gjatë vitit për 180,000€. Kjo pasuri kishte kushtuar fillimisht 250,000€.
- b) Zhvlerësimi i Pronës, Fabrikë dhe Pajisjeve gjatë këtij viti ishte 98,000€.
- c) Dividendët e paguar gjatë vitit ishin 46,000€ dhe janë raportuar në pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet.

**KËRKOHET:**

Përgatitni Pasqyrën e Rrjedhës së Parasë së Gatshme për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2015 për Mia Sh.p.k. në përputhje me SNK 7 - *Pasqyra e Rrjedhës së Parasë*.

**Zgjidhja(3)**

<b>Pasqyra Rrjedhës së Parasë për Mia Sh.p.k. për vitin që përfundon 31 dhjetor 2015</b>		
	<b>'000€</b>	<b>'000€</b>
<b>I. AKTIVITETI OPERATIV</b>		
Fitimi para tatimit	626	
Korrigjimet për:		
Shpenzimet e zhvlerësimit	+ 98	
Humbja nga shitja e P.F.P.	+ 20	
Shpenzimet e interesit	<u>+ 34</u>	
	<b>778</b>	
Zvogëlimi në llogaritë e arkëtueshme	+ 12	
Rritja në stoke	(67)	
Zvogëlimi në llogaritë e pagueshme	<u>(31)</u>	
<i>Paraja e gatshme e gjeneruar nga operacionet</i>	<b>692</b>	
Pagesa e interesit	(34)	
Pagesa e tatimit	<u>(97)</u>	
<b>Rrjedha neto e parasë së gatshme nga aktiviteti operativ</b>		<b>561</b>
<b>II. AKTIVITETI INVESTUES</b>		
Pagesat për blerjen e P.F.P.	(590)	
Paraja e pranuar nga shitja e P.F.P.	<u>+ 180</u>	
<b>Rrjedha neto e parasë së gatshme nga aktiviteti investues</b>		<b>(410)</b>
<b>III. AKTIVITETI FINANCUES</b>		
Paraja e pranuar nga emetimi i aksioneve	+ 40	
Pagesat e bëra për zvogëlimin e kredisë	(134)	
Dividenda e paguar	<u>(46)</u>	
<b>Rrjedha neto e parasë së gatshme nga aktiviteti financues</b>		<b>(140)</b>
<b>Rrjedha neto e parasë së gatshme gjatë vitit</b>		<b>11</b>
<b>Keshi dhe ekuivalentët e keshit në fillim të vitit (54-12)</b>		<b>42</b>
<b>Keshi dhe ekuivalentët e keshit në fund të vitit (53-0)</b>		<b>53</b>

## **Problemi 4**

Më poshtë është dhënë bilanci vërtetues për Kompaninë Mati shpk, një biznes individual:

BILANCI VERTETUES ME 31 MAJ 2016		
	<i>D</i>	<i>K</i>
	€	€
Shitjet		138,078
Blerjet	82,350	
Shpenzimet e transportit	5,144	
Tërheqjet	7,800	
Qeraja dhe sigurimi	6,622	
Posta	3,001	
Marketingu	1,330	
Pagat	26,420	
Borxhet e këqija	877	
Lejimet për të arkëtueshmet		130
Llogaritë e arkëtueshme	12,120	
Llogaritë e pagueshme		6,471
Paraja në dorë	177	
Paraja në bankë	1,002	
Stoqet më 1 qershor 2015	11,927	
Pajisjet me kosto	58,000	
Zhvlerësimi i akumuluar		19,000
Kapitali		<u>53,091</u>
	<u>216,770</u>	<u>216,770</u>

Informatat tjera shtesë janë në dispozicion:

- 1 Nuk është regjistruar fare një faturë e qerasë e cila i takon periudhës raportuese prej €210.
- 2 Nuk janë korrigjuar parapagimet për 880 €(e gjithë shuma është përfshirë në shpenzime).
- 3 Shuma prej €2,211 paraqet transportin për në kompani për blerjet e bëra.
- 4 Pajisjet zhvlerësohen me metodën drejtvizore me 15% në vit.
- 5 Lejimet për të arkëtueshmet duhet të rriten për €40.
- 6 Stoqet në fund janë €13,551.

### **Kërkohet:**

- (a) Përgatitni pasqyrën e të ardhurave për vitin që përfundon më 31 maj 2016 (10 pikë)
- (b) Përgatitni pasqyrën e pozicionit financiar më 31 maj 2016 (10 pikë)

( Totali 20 pikë)

#### Zgjidhja e problemit 4

(a)

MATI shpk

Pasqyra e të ardhurave për vitin që përfundon më 31 maj 2016

	€	€
Shitjet		138,078
Stoqet në fillim	11,927	
Blerjet (LL1)	<u>84,561</u>	
	96,488	
Minus Stoqet në fund	<u>13,551</u>	
Kosto e mallrave të shitur		<u>82,937</u>
Fitimi bruto		55,141
Transporti prej kompanisë(LL2)	2,933	
Qeraja dhe sigurimi (LL3)	5,952	
Posta	3,001	
Marketingu	1,330	
Pagat	26,420	
Borxhet e këqija	877	
Zhvlerësimi (LL4)	8,700	
Borxhet e dyshimta	<u>40</u>	
		<u>49,253</u>
Fitimi neto		<u><u>5,888</u></u>

(b)

MATI shpk

Pasqyra e pozicionit financiar më 31 maj 2016

	<i>Kosto</i>	<i>Zholerësim i i akumuluar</i>	<i>Vlera neto në libra</i>
	€	€	€
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>			
Pajisjet	<u>58,000</u>	<u>27,700</u>	30,300
<i>Pasuritë qarkulluese</i>			
Stoqet		13,551	
Llogaritë e arkëtueshme	12,120		
Minus lejimet	<u>170</u>		
		11,950	
Parapagimet		880	
Paraja në dorë		177	
Banka		<u>1,002</u>	
			<u>27,560</u>
<b>Totali i pasurive</b>			<b><u>57,860</u></b>

## *Kapitali*

Më 1 qershor 2015		53,091
Fitimi për vitin		<u>5,888</u>
		58,979
Tërheqjet		<u>(7,800)</u>
<b>Ekuiteti më 31 maj 2016</b>		<b>51,179</b>

## Detyrimet afatshkurta

Llogaritë e pagueshme	6,471	
Akrualet	<u>210</u>	
		<u>6,681</u>
<b>Totali i ekuitetit dhe detyrimeve</b>		<b><u>57,860</u></b>

## *Llogaritjet*

### 1 Blerjet

€

Nga bilanci vërtetues	82,350
Plus transporti për në kompani	<u>2,211</u>
	<u>84,561</u>

2 Transporti prej kompanisë = €5,144 – €2,211 = €2,933.

### 3 Qeraja dhe sigurimi

€

Nga BV	6,622
Plus akrualet	210
Minus parapagimet	<u>(880)</u>
	<u>5,952</u>

4 Shpenzimet e zhvlerësimit = 15% × €58,000 = €8,700

## **Problemi 5**

Albana sh.p.k është prodhues i specializuar i produkteve mjekësore. Gjatë vitit 2016 kjo kompani ka patur transaksionet e mëposhtme në lidhje me pasuritë afatgjata:

1.Me 1 janar 2016, Albana ka përcaktuar se Patenta e vet #23567 tani nuk ka ndonjë vlerë për shkak se produkti i përfshirë në patentë tani është jashtë përdorimit. Patenta #23567 është blerë nga Albana para 5 viteve për €400,000 dhe saldo në llogarinë e amortizimit të akumuluar të patentës më 31 dhjetor 2015 ishte €200,000.

2.Albana ka blerë patentën #34923 nga konkurrenti më 1 janar 2016 për €4,500,000. Edhe pse për patentën #34923 ka pronësinë ligjore prej 15 viteve, Albana vlerëson se kjo patentë mund të përdoret vetëm për 10 vitet e ardhshme.

3.Paisjet e prodhimit janë blerë në dhjetor 2016. Paisja ka patur faturë të blerjes prej €12,000,000, tatimin në shitje prej €1,560,000 dhe kostot e instalimit prej €340,000. Tre punëtorë të rinj, me paga vjetore prej €330,000 janë punësuar për ta përdorur makinën e re. Makinaria do të jetë plotësisht operationale nga 1 janar 2017.

4.Albana operon në ndërtesën e blerë më 1 janar 2006 për €22,000,000. Në kohën e blerjes së ndërtesës, jeta e vlerësuar e saj ishte 20 vite me vlerë të mbetur të vlerësuar prej €2,000,000. Ndërtesa zhvlerësohej me metodën drejtvizore me €1,000,000 në vit dhe zhvlerësimi i akumuluar i ndërtesës me 31 dhjetor 2015 ishte €10,000,000. Kulmi I ndërtesës është ndërruar më 1 janar 2016 me kosto prej €800,000. Albana vlerëson se kulmi I ri do ta rrisë jetën e vlerësuar ekonomike për 5 vite por nuk do të ketë ndikim në vlerën e mbetur të vlerësuar.

5.Albana ka blerë automjet të ri me 1 janar 2016 me kosto totale prej €600,000. Automjetet kanë jetë të vlerësuar ekonomike prej 5 viteve dhe jetë të mbetur të vlerësuar prej €45,000. Albana përdor metodën e dyfishit të saldove zbritëse për të zhvlerësuar të gjitha automjetet.

### **Kërkohet:**

1.Regjistroni hyrjet në ditar të cilat kërkohen nga Albana më 1 janar 2016 për të njohur humbjen e vlerës së patentës #23567. **(3 pikë)**

2.Përgatitni hyrjen korrigjuese në ditar për të njohur shpenzimet e amortizimit për Patentën #34923 për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2016. Tregoni cfarë lloji i pasurisë është patenta.

**(1 pikë)**

3.Kalkuloni koston e cila do të regjistrohet sa i përket paisjes së blerë të prodhimit nga Albana në dhjetor 2016. Tregoni nëse paisja e prodhimit është pasuri e trupëzuar ose jo e trupëzuar. **(4 pikë)**

4.Përgatitni regjistrimin korrigjues i cili do të bëhet për të regjistruar shpenzimet e zhvlerësimit për ndërtesën për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2016. Tregoni si do të klasifikohen shpenzimet prej €800,000 për kulmin e ri të ndërtesës më 1 janar 2016? Tregoni pse. **(7 pikë)**

5.Përgatitni hyrjet korrigjuese në ditar për të regjistruar shpenzimet e zhvlerësimit për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2016 për automjetet të blera më 1 janar 2016. **(5 pikë) [20 pikë]**

## Zgjidhja e problemit 5

1. Amortizimi i akumuluar – patenta .....200,000  
Humbja nga nxerrja jashtë përdorimit .....200,000  
Patenta..... 400,000

2. Shpenzimet e amortizimit .....450,000  
Amortizimi i akumuluar – patenta (4,500,000 / 10) ..... 450,000

Patenta është pasuri e patrupëzuar jo-qarkulluese

3. \$13,900,000 (12,000,000 + 1,560,000 + 340,000)

Paisja e prodhimit është pasuri e trupëzuar jo-qarkulluese.

4. Shpenzimet e zhvlerësimit ..... 720,000  
Zhvlerësimi i akumuluar-Ndërtesa ..... 720,000

VNL ne datën e ndryshimit=22,000,000-10,000,000=12,000,000

$(22,000,000 - 10,000,000 + 800,000 - 2,000,000) / (20 + 5 - 10)$

Shpenzimet prej \$800,000 në kulmin e ri të ndërtesës do t'i shtohen pasurisë(do të kapitalizohen) për shkak se kjo e rrit jetën e dobishme ekonomike të ndërtesës.

5. Shpenzimet e zhvlerësimit .....240,000  
Zhvlerësimi i akumuluar-Automjete (2/5 × 600,000) ..... 240,000



